



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 17958 Prot.

Shkodër, më 08.7.2026

RAPORT VJETOR
PËR TRANSPARENCËN NË PROCESIN E VENDIMMARRJES
TË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR
PËR VITIN 2025

I. HYRJE

Ky raport vjetor hartohet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për të pasqyruar transparencën në procesin e vendimmarrjes gjatë periudhës janar–dhjetor 2025. Raporti mbështetet në të dhënat e administruara nga Sekretariati i Këshillit Bashkiak dhe në Raportin mbi punën e Këshillit të Bashkisë për 12-mujorin e vitit 2025.

Objekti i këtij raporti kufizohet në veprimtarinë e Këshillit Bashkiak Shkodër, si organ përfaqësues dhe vendimmarrës i bashkisë. Për rrjedhojë, raporti pasqyron vetëm të dhënat që lidhen me mbledhjet e Këshillit, vendimmarrjen, publikimin e akteve, konsultimin publik, kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, si dhe mjetet e informimit të përdorura nga Këshilli Bashkiak.

Raporti shërben edhe si dokument mbështetës për treguesin T02 të Sistemit të Matjes së Performancës (SMP) për vitin referues 2025, lidhur me publikimin e raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes.

II. BAZA LIGJORE DHE RREGULLATORE

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Shkodër dhe detyrimet për transparencë, informim dhe konsultim publik gjatë vendimmarrjes mbështeten, ndër të tjera, në aktet kryesore të mëposhtme:

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Ligji nr. 8480/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- Rregullorja e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Shkodër, miratuar me Vendimin nr. 60, datë 28.12.2020 të Këshillit Bashkiak Shkodër.

III. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE KRYESORE PËR VITIN 2025

Nr.	Treguesi / e dhëna	Vlera për vitin 2025
1	Mbledhje të Këshillit Bashkiak	12
2	Vendime të miratuara nga Këshilli Bashkiak	85
3	Akte të kthyer nga Institucioni i Prefektit	0
4	Pjesëmarrje mesatare në mbledhje	rreth 40 këshilltarë
5	Kërkesa të regjistruara pranë Këshillit	31

Nr.	Treguesi / e dhëna	Vlera për vitin 2025
	Bashkiak	
6	Peticione/nizma qytetare të depozituara	0
7	Projektakte për të cilat u zhvillua konsultim publik	8
8	Seanca/dëgjesa të zhvilluara në kuadër të konsultimeve	19
9	Pjesëmarrës në dëgjesa publike	585
10	Rekomandime të dala nga dëgjesat publike	436
11	Rekomandime të reflektuara në vendimmarrje	67%
12	Realizimi i buxhetit të Këshillit Bashkiak për aktivitetet e vitit 2025	80.7%

IV. TRANSPARENCA NË MBLEDHJET DHE VENDIMMARRJEN E KËSHILLIT

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, Këshilli Bashkiak Shkodër ka zhvilluar 12 mbledhje, në të cilat janë miratuar 85 vendime. Për aktet e miratuara, Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë e tyre dhe nuk ka pasur akte të kthyer.

Dokumentacioni i projektvendimeve të shqyrtuara dhe vendimeve të marra gjatë mbledhjeve të Këshillit është publikuar në faqen web të Këshillit, me qëllim informimin e qytetarëve dhe mundësimin e ndjekjes së procesit vendimmarrës. Në regjistrin online për transparencën e mbledhjeve të Këshillit janë dokumentuar njoftimet/thirrjet e mbledhjeve, oraret e zhvillimit, materialet përkatëse, videot dhe procesverbalet.

Mbledhjet e Këshillit janë transmetuar online përmes pajisjeve të instaluar nga Këshilli Bashkiak, në faqen zyrtare në rrjetin social Facebook dhe në media lokale, duke rritur aksesin e publikut në ndjekjen e vendimmarrjes.

IV.1. Pasqyra e mbledhjeve dhe vendimeve

Muaji	Nr. mbledhjeve	Mbledhje e radhës	Mbledhje jashtë radhe	Vendi	Nr. vendimeve
Janar	1	30.01.2025	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	10
Shkurt	-	-	-	-	-
Mars	1	03.03.2025	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	9
Prill	1	08.04.2025	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	5
Maj	2	07.05.2025	29.05.2025	Salla e mbledhjeve të Këshillit	13
Qershor	1	25.06.2025	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	10
Korrik	-	-	-	-	-
Gusht	1	04.08.2025	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	7
Shtator	1	25.09.2025	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	6
Tetor	1	31.10.2025	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	8

Muaji	Nr. mbledhjeve	Mbledhje e radhës	Mbledhje jashtë radhe	Vendi	Nr. vendimeve
Nëntor	1	27.11.2025	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	10
Dhjetor	2	18.12.2025	29.12.2025	Online (Zoom Meeting)	7

V. KONSULTIMI ME PUBLIKUN

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar kërkesat për njoftimet publike dhe për informimin e publikut për projektaktet që trajtohen nga Këshilli Bashkiak. Njoftimet janë realizuar në faqen zyrtare të Bashkisë/Këshillit, me komunikim elektronik pranë strukturave përkatëse dhe përmes mjeteve të tjera të informimit publik të përdorura nga Bashkia Shkodër.

Për vitin 2025, Këshilli Bashkiak Shkodër ka zhvilluar procedurat e konsultimit publik për 8 projektakte. Këto projektakte janë dokumentuar në regjistrin online të konsultimeve publike dhe janë trajtuar në kuadër të vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak. Në dëgjuesat publike morën pjesë gjithsej 585 qytetarë, biznese, grupe interesi dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak. Nga këto takime dolën 436 rekomandime, nga të cilat 67% u reflektuan në vendimet e marra nga Këshilli.

Shënim metodologjik: për treguesin T01 të SMP-së raportohet numri i projektakteve/vendimeve konkrete të vitit 2025 për të cilat konsultimi publik ishte i detyrueshëm dhe numri i atyre për të cilat konsultimi u zhvillua. Numri i kategorive ligjore të akteve nuk zëvendëson numrin e projektakteve konkrete të vitit referues.

Nr.	Titulli i projektaktit	Nr. seancave	Nr. pjesëmarrësve	Nr. rekomandimeve
1	Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2025–2027 të Bashkisë Shkodër.	12	444	409
2	Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e agjencie funerale/shtëpi funerale (salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër.	1	19	5
3	Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirave publike të Bashkisë Shkodër.	1	21	4
4	Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore “Rosek Drisht” dhe “Drin Gjadër Kir”, Bashkia Shkodër.	1	0	0
5	Për miratimin e vlerës së tarifës ditore për shfrytëzimin e setit çadër (plazh) + 2 (dy) shezlong në plazhin e Velipojës.	1	21	3
6	Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr. 1, datë 22.01.2025 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar.	1	48	5
7	Plani i Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane për Shkodrën.	1	32	10
8	Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore “Rosek Rrjoll”, Bashkia Shkodër.	1	0	0
TOTAL		19	585	436

VI. KËRKESAT, ANKESAT DHE PJESËMARRJA E QYTETARËVE

Në Këshillin Bashkiak Shkodër, për periudhën janar–dhjetor 2025, janë regjistruar 31 kërkesa, të cilat janë trajtuar në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe shkresërisht. Kërkesat kanë pasur kryesisht objekt emërtime rrugësh, kërkesa për informacion, kërkesa për tituj nderi, ndërhyrje në infrastrukturë dhe çështje të tjera me interes publik.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur peticione apo nisma qytetare të depozituara pranë Këshillit Bashkiak. Kërkesat dhe ankesat janë publikuar në regjistrin online të kërkesë-ankesave në faqen web të Këshillit Bashkiak.

Në fund të çdo mbledhjeje plenare është lënë hapësirë për pyetje, kërkesa apo ankesa nga komuniteti, të cilat janë përcjellë përmes këshilltarëve drejt administratës së Bashkisë dhe kanë marrë përgjigje të drejtpërdrejta nga strukturat përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë.

VII. PUBLIKIMI I INFORMACIONIT DHE AKSESI ONLINE

Këshilli Bashkiak Shkodër ka vijuar publikimin e materialeve të mbledhjeve dhe të vendimeve në faqen zyrtare, për të mundësuar njohjen e publikut me procesin e vendimmarrjes. Informacioni i publikuar përfshin njoftimet e mbledhjeve, rendin e ditës, projektvendimet, vendimet e miratuara, procesverbalet, videot e mbledhjeve dhe dokumentacionin shoqërues.

Këshilli Bashkiak ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me qytetarët edhe përmes rrjeteve sociale dhe transmetimeve online, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje, përdorimin e instrumenteve të kërkesë-ankesave dhe rritjen e llogaridhënies ndaj komunitetit.

Faqja zyrtare për konsultim dhe ndjekje të informacionit: <https://bashkiashkoder.gov.al/> dhe rubrika e Këshillit Bashkiak: <https://bashkiashkoder.gov.al/keshilli-bashkiak/>

VIII. PËRMBLEDHJE PËR TREGUESIT SMP TË KËSHILLIT BASHKIAK

Kodi	Përshkrimi	Përgjigjja / vlera
T01.1	Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	8
T01.2	Numri i akteve/projektakteve për të cilat është zhvilluar konsultimi publik	8
T01	Akte për të cilat është zhvilluar konsultimi publik kundrejt akteve për të cilat konsultimi është i detyrueshëm	100%
T02.1	Publikimi i raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Po.

X. PËRFUNDIME

Për vitin 2025, Këshilli Bashkiak Shkodër ka ushtruar veprimtarinë vendimmarrëse duke respektuar parimet e transparencës, informimit publik dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve. Procesi i vendimmarrjes është shoqëruar me publikim të dokumentacionit, transmetim online të mbledhjeve, administrim të kërkesave dhe ankesave, si dhe zhvillim të konsultimeve publike për projektaktet për të cilat konsultimi ishte i detyrueshëm.

Në bazë të të dhënave të administruara për vitin 2025, Këshilli Bashkiak Shkodër raporton 8 projektakte për të cilat zhvillimi i konsultimit publik ka qenë i detyrueshëm dhe 8 projektakte për të cilat konsultimi është zhvilluar, duke rezultuar në realizimin 100% të treguesit T01 për pjesën e Këshillit Bashkiak.

XI. DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS

- Raporti mbi punën e Këshillit të Bashkisë për 12-mujorin e vitit 2025;
- Lista/tabela e konsultimeve publike të zhvilluara gjatë vitit 2025;
- Regjistri online i konsultimeve publike dhe dokumentacioni shoqërues për secilin projektakt;
- Regjistri online i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, vendimeve, procesverbaleve dhe videove;
- Regjistri i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve;

SEKRETARIATI I KËSHILLIT

IRMA SULISHTI

SABINA DANAJ